



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 31.01.2022, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Nasip Naço- kryetar i Komisionit

Rendi i ditës :

1. Miratimi i kalendarit 3-javor të punës së komisionit
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 5, 8, 18, 22 e 23 nëntor 2021, si dhe të mbledhjeve datë 1, 13, 14, 17 dhjetor 2021
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për ngritjen dhe funksionimin e një qendre të përbashkët policore dhe doganore”,

Marrin pjesë:

Nasip Naco, Xhemal Qefalia, Antoneta Dhima, Paulin Sterkaj, Bardhyl Kollcaku, Vullnet Sinaj, Toni Ggogu, Denis Deliu, Pranevera Resulaj, Luan Duzha, Ferdinant Xhaferraj Lindita Metaliaj, Luan Baci, Kasem Mahmutaj, Ervin Salianji, Isuf Celaj.

Mungojnë:

Ilirian Pendavinji, Flamur Noka, Enkelejd Alibeaj, Agron Cela.

Të ftuar:

Andi Mahila – Zëvendësministër i Brendshëm

Eduart Merkaj – Drejtor i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin

Silvana Dervishi – Specialiste në Drejtorinë e Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në Ministrinë e Brendshme.

HAPET MBLEDHJA

Nasip Naço – Mirëmëngjesi!

Përshëndetje të gjithëve!

Hapim seancën e Komisionit për Sigurinë Kombëtare, për ditën e sotme.

Në rendin e ditës kemi:

1. Miratimin e kalendarit trejavor të punës së komisionit.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 5, 8, 18, 22 e 23 nëntor 2021, si dhe të mbledhjeve datë 1, 13, 14, 17 dhjetor 2021;

Kush është dakord me miratimin e kalendarit trejavor dhe me miratimin e procesverbalit të mbledhjeve?

Pro? Kundër s'ka.

Miratohet!

Fillojmë me shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për ngritjen dhe funksionimin e një qendre të përbashkët policore dhe doganore”, në cilësinë komisionit përgjegjës.

Të ftuar nga Ministria e Brendshme janë zoti Andi Mahila – zëvendësministër i Brendshëm, zoti Eduart Merkaj – Drejtor i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, zonja Silvana Dervishi – Specialiste në Drejtorinë e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në Ministrinë e Brendshme.

Fjala është për ju, zoti Mahila, për një relacion të shkurtër.

Andi Mahila – Faleminderit i nderuari kryetar i komisionit!

Të nderuar anëtarë deputetë të parlamentit,

Akti për të cilin do të diskutohet është paraqitur nga Këshilli i Ministrave në Kuvendin e Shqipërisë për ratifikim, marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për ngritjen dhe funksionimin e një qendre të përbashkët policore dhe doganore.

Ky akt është bashkiniciuar nga institucioni i Ministrisë së Brendshme e i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Në zbatim të strategjisë së menaxhimit të integruar të kufijve, mbështetur në rekomandimet e BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor, strukturat e Ministrisë së Brendshme dhe ato të Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, pranë Policisë së Shtetit, janë përqendruar në fusha konkrete të bashkëpunimit ndërkufitar me strukturat homologe të Greqisë, bashkëpunim i cili, bazuar në rezultatet e deritanishme, vlerësohet të jetë në nivel shumë të mirë.

Me Greqinë ne ndajmë një kufi tokësor me një gjatësi prej 336, 3 kilometrash katrorë. Nga këto, 233 kilometra janë kufij tokësorë, 78 kilometra janë kufij detarë, 7, 1 kilometra janë kufij liqenorë, ndërsa 18, 1 kilometra janë kufij lumorë dhe përrrenjsh.

Janë në funksion shtatë pika të kalimit kufitar, në varësi të ndarjes, sipas dinamikës së lëvizjes së shtetasve, mjeteve dhe mallrave. Duke ndarë të njëjtin kufi, siç e theksova më lart, në shumicën e rasteve përballja me problematikat është e ngjashme. Problemet e ngjashme kërkojnë zgjidhje të përbashkëta. E vetmja rrugë për të pasur progres të qëndrueshëm në lidhje me çështjet e përbashkëta me të cilat përballemi, është të punuarit sa më afër me partnerin. Ky është thelbi i qëllimit, për të cilin është përgatitur kjo marrëveshje.

Ky projektakt është iniciuar në kuadër të forcimit të bashkëpunimit dhe përmirësimit të shkëmbimit të informacionit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë për të rritur efikasitetin në luftën kundër krimit të organizuar e lidhjeve të tij, migracionit të paligjshëm, trafikimit të drogës, ekstremizmin e dhunshëm, radikalizimin si dhe krimet e rënda.

Në marrëveshje janë përcaktuar rregullat e përbashkëta për funksionimin e qendrës, e cila do të ketë një komision të përbashkët, neni 9, dhe një rregullore, neni 4. Komisioni i përbashkët do të përbëhet nga katër anëtarë për secilën palë. Këta katër janë të ndarë sy plus dy, domethënë dy nga Policia e Shtetit, dy nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, duke qenë se është një marrëveshje që i prek të dyja institucionet. Ky komision do të mbledhet dy herë në vit. Komisioni miraton rregulloren e funksionimit të qendrës.

Kjo qendër e përbashkët e shkëmbimit të informacionit dhe e koordinimit të bashkëpunimit do të pozicionohet në territorin e Republikës së Greqisë, në ndërtesën aktuale të pikës së kalimit kufitar të Kakavijës. Kjo qendër nuk ka personalitet juridik, pra nuk ka autoritet në vendimmarrje.

Pikë e veçantë e parashikuar në këtë marrëveshje është shkëmbimi i përbashkët i të dhënave personale ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve, që do të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës kombëtar, duke pasur parasysh kushtet e përcaktuara nga autoriteti kompetent ofrues dhe parimeve vijuese, të cilat aplikohen si për përpunimin e të dhënave automatike dhe joautomatike, kjo marrëveshje ka parashikuar një kapitull të veçantë me dy nene, 12 e 13, ku janë të detajuara të gjitha kushtet dhe elementet e funksionimit të shkëmbimit të informacioneve në lidhje me të dhënat personale, por edhe për informacionet e klasifikuara.

Së bashku me aktin, Ministria e Brendshme, si lider i këtij procesi negocimi, ka paraqitur në Kuvendin e Shqipërisë edhe relacionin përkatës, në të cilin shpjegohen me detaje të gjitha nenet. Për të mos u zgjatur në pjesën e elementëve teknikë apo të fushave, në të cilat përqendrohet shkëmbimi i informacionit, po kaloj te pjesa e procedurës. Siç e thashë, Ministria

e Brendshme ka qenë lider në procesin e negocimit, natyrisht në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Janë ndjekur të gjitha procedurat konform ligjit 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Gjatë fazës së negocimit dhe miratimit në parim, ky akt është dërguar për mendim te Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, te Ministria e Drejtësisë, te Prokuroria e Përgjithshme, te Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në DSIK. Në fazën e marrjes së mendimit në formën e miratimit, Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Drejtësisë janë shprehur parimisht dakord. Marrëveshja është miratuar në parim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 178, datë 4. 4. 2018 dhe është nënshkruar më datë 18 janar 2021, në Kakavijë, nga zëvendësministri Julian Hodaj.

Për sa i përket pjesës së kostove dhe të pajisjeve, kostot e përafërta financiare nga shpenzimet që do të lindin për veprimtarinë e qendrës, do të jenë si më poshtë:

-Shpenzimet e energjisë elektrike do të jenë afërsisht 50 euro në muaj, gjithsej 600 euro në vit.

-Shpenzimet e ujit do të jenë afërsisht 15 euro në muaj, gjithsej 180 euro në vit.

-Shpenzimet e mirëmbajtjes do të vlerësohen sipas punimeve të kryera, të cilat do të mbulohen nga të dyja palët.

Për shpenzime të personelit nuk do të ketë efekte financiare shtesë, pasi punonjësit do të jenë pjesë e strukturës aktuale të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit si dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Kostot financiare që përmenda më lart janë parashikuar për t’u përballuar nga programi buxhetor “Policia e Shtetit”.

Shpenzimet që do të lindin nga veprimtaria e qendrës, si mirëmbajtja, energjia elektrike, uji dhe ngrohja, do të ndahen në mënyrë të barabartë midis palëve.

Në përfundim, vlerësoj se funksionimi i kësaj qendre nuk do të sjellë mbivendosje me organet doganore policore, pasi qëllimi është rritja dhe forcimi i bashkëpunimit të autoriteteve kompetente të palëve ndërmjet shkëmbimit të informacionit, duke mirëpërcaktuar detyrat e qendrës, të pavarura nga detyrat e organeve operationale doganore dhe policore.

Falemnderit për vëmendjen! Jam në gatishmëri për t’iu përgjigjur pyetjeve.

Nasip Naço – Falemnderit, zoti Mahila!

Fjalën e ka relatorja, zonja Antoneta Dhima.

Antoneta Dhima – Falemnderit, zoti kryetar!

Falemnderit zoti zëvendësministër, për prezantimin e projektligjit!

Në fakt, ky projektligj ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për ngritjen dhe funksionimin e një qendre të përbashkët policore dhe doganore.

Përparësitë që priten nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje ka lidhje me luftën kundër krimit ndërkufitar, krimit të organizuar e lidhjeve të tij, luftën kundër emigracionit të paligjshëm, trafikimit të drogave, ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit dhe krimeve të rënda.

Gjithashtu, është konsideruar i nevojshëm nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje teknike duke iu referuar seriozitetit të krimit ndërkufitar, si dhe nevojës për të marrë masa të përbashkëta kundër kërcënimeve ndërkufitare nga ana e dy autoriteteve. Funksionet, detyrat dhe kompetencat e secilës palë, përcaktimi i formës së komunikimit dhe të bashkërendimit të veprimeve ndërmjet tyre do të jenë të përcaktuara në rregullore, ashtu sikundër e theksoi edhe zëvendësministri, të përfituara mbi bazën e interesave të përbashkëta, mbi bazën e parimeve të barazisë dhe parimit të reciprocitetit, të cilat miratohen nga komisioni i përbashkët.

Fushat dhe metodologjitë e bashkëpunimit si dhe shkëmbimi i informacionit janë të përcaktuara shumë qartë edhe në relacionin që shoqëron projektligjin, siç është migracioni i paligjshëm, kontrabandimi i emigrantëve e i refugjatëve, trafikimi i qenieve njerëzore dhe veprimtaritë e paligjshme që lidhen me to, ekstremizmi i dhunshëm e rekrutimi i luftëtarëve të huaj, krimet dhe shkeljet që lidhen me falsifikimin e dokumenteve të udhëtimit, krimet e shkeljet që lidhen me kultivimin e paligjshëm, prodhimin, eksportimin, transportimin dhe trafikimin e lëndëve narkotike e të substancave psikotrope, krimet e shkeljet që lidhen me mjetet motorike, persona të cilëve u është refuzuar hyrja në territoreve të shteteve të të dyja palëve, shkeljet ose përpjekjet për të shkelur legjislacionin kombëtar të njëjës prej palëve në kalimin e kufirit të shtetit të tij, trafikimi i paligjshëm i pasurisë kulturore, personat e humbur e të tjera, të cilat janë shprehur shumë qartë edhe në relacionin që shoqëron projektligjin.

Marrëveshja përcakton se komunikimi do të kryhet në gjuhën shqipe, greke, por njëkohësisht edhe në atë angleze, ndërsa zyrtarët e qendrës do të jenë të detyruar të regjistrojnë e të arkivojnë të gjitha kërkesat e përgjigjet. Përdorimi dhe ruajtja e dokumentacionit në qendër do të bëhet në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi, që kanë të bëjnë me autoritetet përkatëse. Po ashtu, projektligji parashikon edhe statusin e zyrtarëve, që do të kryejnë detyrat e tyre në përputhje me legjislacionin e palës që ata përfaqësojnë, duke respektuar legjislacionin e asaj pale, në territorin e së cilës është ngritur qendra.

Gjithashtu, sikundër e tha edhe zëvendësministri, është përcaktuar numri i personave për secilën palë. Lista dhe emrat e tyre, përgjegjësitë e tyre administrative e disiplinore, uniforma, kartat e shërbimit, përdorimi i tyre si dhe legjislacioni në të cilin janë bazuar. Edhe përbërjen, zëvendësministri e preku në fjalën e tij.

Brenda kuadrit të kësaj marrëveshjeje, palët mund të shkëmbejnë ekspertë, me qëllim trajnimin dhe përfitimin nga ekspertiza e tyre, por dhe mund të organizojnë trajnime të përbashkëta, nëse është e nevojshme. Po ashtu, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, autoritetet kompetente të palëve mund të shkëmbejnë ekspertizë nëpërmjet qendrës, lidhur me çështjet e parashikuara në këtë marrëveshje, me qëllim thjeshtëzimin dhe harmonizimin e procedurave e të praktikave. Njëkohësisht, shkëmbimi i përbashkët i informacionit, i të dhënave personale ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve do të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës kombëtar, duke pasur parasysh kushtet e përcaktuara nga autoriteti kompetent ofrues dhe parimet vijuese.

Secila palë përgjegjëse procedohet penalisht, gjë që duhet ta theksoj, sepse zëvendësministri nuk e tha në fjalën e tij, pra procedohet penalisht sipas ligjeve të shtetit që është ofrues i të dhënave, nëse keqkuptohen apo shpërdorohen të dhënat personale të ofruara prej tij. Të gjitha konfliktet që mund të rrjedhin nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje, do të zgjidhen nga koordinatorët. Në rast se zgjidhja nuk arrihet, konfliktet do të zgjidhen nëpërmjet konsultimeve, në kuadër të komisionit të përbashkët. Në rast se zgjidhja e tyre nuk arrihet nga komisioni i përbashkët, konfliktet do të zgjidhen nëpërmjet konsultimeve midis palëve, nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Lidhur me sigurinë kombëtare ose interesa të tjera publike, ose në rast se nuk do të jenë në përputhje me legjislacionin kombëtar, secila palë mund të mohojë ndihmën përkohësisht, plotësisht ose pjesërisht. Pala tjetër do të informohet menjëherë me shkrim, në lidhje me arsyen dhe bazën e një refuzimi të tillë.

Ajo që duhet theksuar është fakti se miratimi i kësaj aktmarrëveshjeje bën të mundur krijimin e kësaj qendre, gjë që nuk mund të sjellë mbivendosje me organet doganore dhe policore, të cilën e theksoi edhe zëvendësministri në fjalën e tij. Efektet financiare i shprehu shumë qartë zëvendësministri. Ato janë shumë të pakta dhe do të përballohen nga programi buxhetor “Policia e Shtetit”.

Prandaj, të nderuar kolegë dhe kolege ju ftoj që ta miratojmë këtë aktmarrëveshje.

Falemnderit!

Nasip Naço – Falemnderit, zonja Dhima!

Nëse keni pyetje, mund t’i bëni, para se të fillojmë me diskutimet.

Po, zoti Salianji.

Ervin Salianji – Përshëndetje!

Së pari, kjo është një marrëveshje e kërkuar nga pala greke apo është kërkuar nga të dyja palët?

Së dyti, është bërë përzgjedhja e doganës Kakavijës, nëse kalohet një marrëveshje e tillë; pse nuk përfshihen të gjitha doganat, përfshi doganës e Kapshticës, për shembull, për të pasur një qendër të tillë?

Së treti, për të sqaruar edhe publikun, po për të qenë të qartë edhe ne: kjo do të shërbejë vetëm për shkëmbimin e informacionit në lidhje me çështjet e diskutuara apo mund të ishte mundësia për të pasur pika të përbashkëta të kalimit, duke qenë se me Greqinë ka pasur në mënyrë të përsëritur problematika në lidhje me kalimin, sidomos në periudhën kur qytetarët shqiptarë vinin në Shqipëri dhe u duhej të kalonin në Greqi?

Nasip Naço – Falemnderit!

Zoti Mahila.

Andi Mahila – Falemnderit, i nderuar!

Në përgjigje të pyetjeve, fillimisht marrëveshja është kërkuar të negociohet e të diskutohet nga pala greke. Negocimi është drejtuar nga Ministria e Brendshme, siç e thashë në fjalën time, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë. Përzgjedhja e pozicionimit të kësaj qendre në Kakavijë është domethënëse, për shkak se Kakavija është pika e kalimit kufitar që përballon fluksin më të madh të komunikimit me Greqinë, për shtetasit, mallrat dhe mjetet.

Duke e lidhur me pyetjen e tretë, kjo është një qendër e përbashkët e shkëmbimit dhe analizimit të informacionit. Nuk është një qendër e përbashkët e kalimit të shtetasve, të mjeteve dhe të mallrave. Meqenëse është një qendër e përbashkët e shkëmbimit dhe analizimit të informacionit që lidhet me efikasitetin e luftës kundër krimit të organizuar, migracionit, rrjeteve dhe të gjithë elementëve të tjerë, që përmendëm, kjo qendër trajton të gjitha çështjet dhe të gjithë elementët, të cilat janë të ngjashme për të gjitha pikat e kalimit kufitar. Në fjalën time thashë se kemi shtatë pika të kalimit kufitar me Greqinë. Dua ta theksoj edhe një herë tjetër, që kjo nuk është qendër e përbashkët e kalimit të qytetarëve, të mjeteve e të mallrave, por është një qendër e përbashkët e analizimit dhe shkëmbimit të informacionit në lidhje me çështjet e përbashkëta.

Nasip Naço – Po, zoti Baçi.

Luan Baçi – Ju thoni se në krijimin e kësaj qendre nuk do të silltet një mbivendosje në organet doganore policore, pasi qëllimi është forcimi dhe rritja e bashkëpunimit të autoriteteve e të tjera e të tjera. Si do ta arrini këtë mosmbivendosje ose mospërplasje të kompetencave mes policisë, doganës, nëpërmjet kësaj marrëveshjeje? Do të jetë një komision tjetër i përbërë nga përfaqësues?

Andi Mahila – Themi që nuk ka mbivendosje për çështjet operative, ekzekutive. Në marrëveshje është e përcaktuar që zyrtarët e qendrës nuk kanë asnjë kompetencë dhe nuk

marrin pjesë në veprime operative, të cilat u përkasin policisë apo Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Pra, neni 8, pika 3 thotë: “Zyrtarët e caktuar në qendër nuk do të marrin pjesë drejtpërdrejt në ekzekutimin e veprimtarive operacionale dhe në kryerjen e kontrolleve kufitare në shtetin e palës tjetër.”

Kjo qendër është përcaktuar të ketë në mënyrë të barabartë pesë zyrtarë nga secila palë. Nga pala jonë janë përcaktuar. Është një punonjës policie me gradën nënkomisar dhe katër punonjës policie me gradën inspektor. Angazhimi i tyre është vetëm për grumbullimin, shkëmbimin dhe analizimin e informacionit. Nuk kanë lidhje fare me pjesën e funksionimit të pikës së kalimit kufitar dhe funksionimin e Komisarariatit të Kufirit dhe Migracionit.

Në këtë kuptim, thashë që nuk ka mbivendosje. Angazhimi i zyrtarëve në këtë qendër nuk ka lidhje me pjesën e aktivitetit ekzekutiv operacional të Drejtorisë së Forcave të Policisë dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Nasip Naço – Falemnderit!

Duke qenë se nuk ka as pyetje e as diskutime, le ta hedhim në votim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Megjithëse kemi bërë një marrëveshje, që të ishte zëvendësministri, sepse është prishur tërë pjesa e kalendarit. Është në traditën e Partisë Socialiste, që çdo të hënë në orën 10 bëjë mbledhjen e grupit parlamentar, ndaj do të donim mirëkuptimin tuaj, që nëse s’kemi më pyetje, ta ndërpresim për 20 minuta dhe pastaj të rifillojmë, nëse do të ketë diskutime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull! Nëse zoti Salianji ka një diskutim vetëm dy minuta, besoj se më pas e mbyllim dhe kalojmë në votim.

Po, zoti Salianji!

Ervin Salianji – Është një qëndrim që duhet mbajtur për të sqaruar qytetarët, sepse në fillim edhe ne mund ta kemi kuptuar si një pikë të kalimit të përbashkët, që do të ishte një zgjidhje e mirëpritur. Pa diskutim që ne do të jemi pro, siç jemi për çdo marrëveshje ndërkombëtare. Duket qartazi edhe nga fakti që është kërkuar nga pala greke, por edhe nga tërë situata e kriminalitetit të shtuar, qoftë me trafikun e klandestinëve, qoftë me krimin e organizuar, qoftë me trafikun e drogave në raport me Greqinë, me ekstremizmin e dhunshëm apo me krimet e rënda, të cilat fatkeqësisht, për shkak të gjendjes së rëndë të sigurisë e të kimit në Shqipëri, janë eksportuar edhe në vendet e Bashkimit European, edhe në Greqi, por duket se po kërkohet një marrëveshje tjetër nga një shtet tjetër i Bashkimit European, kufitar në këtë rast, duket qartazi se po kërkon më shumë informacion. Kjo marrëveshje tregon edhe një herë tjetër, edhe nga aktorë të jashtëm, edhe nga shtete të tjera, atë që shqiptarët shohin përditë: që

këtu kërcet arma në mes të ditës, që krimi është në nivelet më të larta dhe se Shqipëria po shkon keq e më keq. Inshallah kjo i shërben edhe Shqipërisë, për shkak të informacioneve që mund të ketë në lidhje me elementë kriminalë në Greqi. Edhe një herë tjetër, kjo faktori atë që ne e kemi thënë prej tetë vitesh, gjë për të cilën do të kemi kohë të diskutojmë, që të mos ju pengojmë mbledhjen e grupit.

Nasip Naço – Falemnderit!

Po, zoti Xhaferraj!

Më pas e hedhim në votim.

Ferdinand Xhaferraj – Unë nuk do flas në lidhje me marrëveshjen, kam diçka jashtë marrëveshjes. Besoj se të gjithë ne kolegët që kryem vizitën në Kosovë, biem dakord që kishim një vizitë të shkëlqyer, ndaj do të lutesha që në rendin e ditës së mbledhjes së ardhshme, nga ana e këshilltarëve të komisionit që morën pjesë në atë vizitë, të përgatitej një axhendë pune në lidhje me problemet konkrete që ne nxorëm, me dëshirën e mirë që të mos i lëmë gjërat të ngelen thjesht në nivel vizitash. Kështu që, këshilltarët të na propozojnë një axhendë të përbashkët, që ne ta miratojmë në mbledhjen tjetër të komisionit.

Nasip Naço – Falemnderit, zoti Xhaferraj!

E hedhim në votim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Greqisë, për ngritjen dhe funksionimin e një qendre të përbashkët policore dhe doganore”.

Neni 1. Kush është pro?

Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 2. Kush është pro?

Kundër? Abstenim?

Miratohet!

E hedhim në votim në tërësi.

Kush është dakord?

Projektligji miratohet!

Falemnderit!

Po bëj edhe një njoftim për të gjithë anëtarët e Komisionit të Sigurisë Kombëtare, që nesër dhe pasnesër do të bëjmë një vizitë në Gjirokastrë, në bashkëpunim me OSBE-në. Besoj se do të jetë një rast i mirë për të diskutuar edhe për marrëveshjen me autoritetet greke e shqiptare në pikën e kalimit.

MBYLLET MBLEDHJA